

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Vlerësimi i Kontributit të UNICEF në Shqipëri për Kuadrin Normativ të Reformës së Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror 2013-2019

Prill 2020

unicef 
for every child

Autorët: Camille Massey dhe Merita Poni, mbështetur nga Elayn Sammon.

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikat apo pikëpamjet e UNICEF-it.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materialin e këtij raporti në botimet e tyre. Si zotërues i të drejtave të autorit, UNICEF Shqipëri kërkon citimin përkatës dhe një kopje të botimit.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni:

Zyra e UNICEF-it në Shqipëri
Rruga Skënderbej,
Godina e OKB-së, Kati i tretë
Tiranë, Shqipëri
Nr. i telefonit: +355 4 45 48 400
Email: tirana@unicef.org

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Vlerësimi i Kontributit të UNICEF në Shqipëri për Kuadrin Normativ të Reformës së Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror 2013-2019

Prill 2020



HYRJE

Deri në vitet 90-të, Shqipëria nuk kishte një sistem modern të mbrojtjes shoqërore. Pas fillimit të tranzicionit demokratik dhe ekonomik në vitet 90-të, një numër gjithnjë e më i madh individësh nuk shërbeheshin më nga sistemi që ekzistonte, duke sjellë kështu krijimin e një forme embrionike të ndihmës shoqërore, kryesisht të bazuar në pagesa në të holla. Në fillim të mijëvjeçarit, mbështetja ndërkombëtare dhe kontributin e saj në përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe vendim-marrjen përkatëse. Më tej, nga viti 2007 deri në vitin 2009, Qeveria e Shqipërisë (QSH) me mbështetjen e UNICEF-it dhe agjencive të tjera të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) ngriti shërbime të reja shoqërore përmes mbrojtjes së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo përvojë e shtyu UNICEF-in të marrë në konsideratë cenueshmërinë e fëmijëve brenda kontekstit më të gjerë të cenueshmërisë së familjeve dhe nevojën për një qasje strategjike gjithëpërfshirëse ndaj shërbimeve të kujdesit shoqëror (SHKSH).

Programi i Bashkëpunimit ndërmjet QSH dhe UNICEF-it 2012 - 2016 e mandatoi UNICEF-in të mbështeste projektimin e një sistemi të integruar të shërbimeve shoqërore në nivel të decentralizuar, ndërsa Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 përcaktonte vizionin e qeverisë për një sistem të integruar të shërbimeve shoqërore. Në vitin 2012, UNICEF-i, Qeveria e Shqipërisë dhe Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) projektuan programin e parë për SHKSH në vend, me qëllim krijimin e një sistemi që do t'i përgjigjej parimeve të UNICEF-it dhe që do të ishte i aksesueshëm nga çdokush që përballet me situata cenueshmërie dhe përjashtimi, si kërkesë bazë për uljen e varfërisë dhe përfshirjen sociale të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, QSH ka drejtuar ngritjen e një sistemi të mbrojtjes shoqërore dhe ka miratuar politika kyçe dhe akte legjislativë për politikën e mbrojtjes shoqërore.

Programi i parë i UNICEF-it për SHKSH-në (2012-2016) kishte si qëllim të krijonte një kuadër kombëtar gjithëpërfshirës normativ, të zbatueshme nga ofruesit e shërbimeve në njësitë e qeverisjes vendore në nivel bashkie. Programi i dytë (2017-2021), pjesë e programit "Askush të Mos Mbetet Pas", i cili zbatohet së bashku me UNDP, UN Women dhe UNFPA, përqendrohet në mobilizimin, vënien në funksion dhe zbatimin e 'gurëve të themelit' të përcaktuara në kuadër të programit pararendës. UNICEF ka punuar për vendosjen e gurëve të themelit të reformës së SHKSH-së në Shqipëri, mishëruar nga hartimi i politikave, legjislativës dhe burimeve njerëzore në nivel vendor. Me mbështetjen e SDC-së, UNICEF-i në Shqipëri ka ndërmarrë një sërë veprimtarish që sistemi të jetë i aksesueshëm nga fëmijët dhe që të respektojë parimet e të Drejtave të Njeriut dhe të të Drejtave të Fëmijës të promovuara nga UNICEF-i në Shqipëri, si: drejtësi dhe përfshirje, aksesueshmëri, qëndrueshmëri, llogaridhënie, përqendrim në ciklin e jetës, efektshmëri dhe ndjeshmëri për fëmijën dhe të gjitha format e cenueshmërisë.

Në vitin 2013, UNICEF-i ishte i përfshirë në mbështetje për përpjekjet e qeverisë lidhur me ngritjen e një sistemi të SHKSH-së, dhe aktualisht programe të tilla kanë tetë vjet që po zbatohen me një buxhet të përgjithshëm prej rreth 2,55 milion Dollarë. Ndërkohë, UNICEF-i po përmirëson qasjen e vet të programimit në vende me të ardhura mesatare (VAM). Si pasojë e problematikave të ndryshme karakteristike për vende të tilla, rasti i UNICEF-it në Shqipëri është shembull konkret i qasjes së UNICEF-it në rajon në kuadër të realiteteve të vjetër dinamike të asistencës për zhvillim. Kjo e bën vlerësimin e kontributit të agjencisë për kuadrin normativ të reformës për SHKSH-në në të gjithë Shqipërinë gjatë periudhës 2013-2019 edhe më të rëndësishëm.

Kjo përmbledhje teknike paraqet pikat kyçe të Raportit të Vlerësimit të kontributit të UNICEF-it për kuadrin normativ të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri gjatë periudhës 2013-2019 (me poshtë referuar si "vlerësimi"), kërkuar nga UNICEF-i në Shqipëri. Raporti i plotë i vlerësimit mund të gjendet në Faqen e internetit të [UNICEF Shqipëri](#).

HISTORIKU

Arsyetimi për ndërmarrjen e vlerësimit ishte ‘matja’ e kontributit të UNICEF-it përpara përfundimit të projektit (Askush të Mos Mbetet Pas) në vitin 2021. Si rrjedhojë, u synua edhe testimi dhe demonstrimi i vlefshmërisë së teorisë së ndryshimit, për qëllimet e planifikimit për të ardhmen në Shqipëri dhe në VAM të tjera nga ana e UNICEF-it. Vlerësimi u programua edhe për të përcaktuar më mirë rolin e UNICEF-it në mbështetje të SHKSH-së në Shqipëri, duke marrë në konsideratë angazhimin e parashikuar të aktorëve të rinj në zhvillimin e SHKSH-së në Shqipëri, veçanërisht të BE-së.

Përfituesit dhe auditori i synuar. Përfituesit fundorë të ndërhyrjes së vlerësuar janë të gjithë banorët e Shqipërisë, veçanërisht fëmijët, familjet dhe komunitetet e tyre, duke u përqendruar tek individët e cenuar, si Romët, personat me aftësi të kufizuara, dhe individët e ndikuar nga varfëria. Për më tepër, raporti i vlerësimit mund të jetë me interes edhe për botën akademike në vend dhe përtej. Përfituesit e drejtpërdrejtë të ndërhyrjes janë UNICEF-i në Shqipëri, Zyra Rajonale e UNICEF-it në Gjenevë, dhe institucionet zbatuese të reformës, si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Bashkitë e Shqipërisë, si dhe partnerët zbatues, palët ndërkombëtare të interesit (BE), dhe komuniteti i donatorëve, përfshirë Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për shkak të rolit të saj si mbështetëse e reformës së SHKSH-së.

Qëllimet e vlerësimit janë të dyfishta: të përforcojë llogaridhënien e UNICEF-it ndaj qeverisë dhe institucioneve kombëtare, donatorëve, fëmijëve dhe familjeve dhe palëve të tjera të interesit, si dhe të ofrojë informacion për vendim-marrjen me njohuri dhe prova lidhur me arritjet, mundësitë dhe sfidat ende të pranishme.

Objektivat e vlerësimit ishin të:

- ♦ Vlerësonin kontributin faktik të dhënë nga UNICEF-i për krijimin e kuadrit normativ për reformën e SHKSH-së.
- ♦ Identifikonin progresin e bërë deri tani sa i përket mbështetjes së shtrirjes së këtij sistemi për qytetarët.
- ♦ Identifikonin mësimet e nxjerra dhe bërjen e rekomandimeve për të përmirësuar ndërhyrjet dhe për të mbështetur më mirë kuadrin normativ për shërbimet e kujdesit shoqëror.

Objekti i vlerësimit mbuloi nismat e UNICEF-it për të mbështetur kuadrin normativ për reformën e SHKSH-së, përfshirë të gjithë paketën ligjore, strategjitë, rregulloret dhe kapacitetet institucionale, veçanërisht sa i përket kontributit të UNICEF-it si pjesë e dy projekteve të mbështetura nga SDC-ja.

Grupet e popullatës të synuara nga ndërhyrja, dhe që mbulohen nga vlerësimi, përfshijnë thuajse të gjithë qytetarët dhe banorët e Shqipërisë që, në një moment apo një tjetër të ciklit të jetës së tyre, përballen me pengesa lidhur me përfshirjen sociale si pasojë e cenueshmërisë, duke pasur kështu nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Theks i veçantë vihet tek grupet e cenueshme që përfshijnë fëmijët dhe familjet e tyre të ndikuara nga cenueshmëri si varfëria, aftësitë e kufizuara, si dhe individë që janë pjesë e pakicave kombëtare, si komunitetet Rome dhe Egjiptiane.

Mbulimi gjeografik i vlerësimit është i gjithë territori i Shqipërisë. Ndërhyrja e UNICEF-it në Shqipëri synoi të gjithë territorin përmes përgatitjes së politikave, dhe dokumenteve legjislativë dhe rregullatore që përbënë kuadrin normativ të SHKSH-së për të gjithë Shqipërinë. Më tej ndërhyrja pilotoi zbatimin e këtij kuadri, veçanërisht vlerësimin dhe planifikimin e SHKSH-së bazuar në të drejta në nivel bashkie, në 14 bashki të përzgjedhura sipas një mënyre me bazë vullnetare nga UNICEF-i dhe QSH-ja.

Shtirja kohore e vlerësimit mbuloi nismat e UNICEF-it të ndërmarra gjatë periudhës 2013-2019.

Kriteret e Vlerësimit. Sipas përcaktimeve të termave të referencës dhe duke marrë në konsideratë objektin e vlerësimit që mbulon gamën e ndërhyrjeve të UNICEF-it në Shqipëri në të gjithë vendin gjatë një periudhe gjashtë vjeçare, nga pikëpamja metodologjike, vlerësimi u përqendrua në kritere të veçanta që u vlerësuan përmes pyetjeve kyçe të vlerësimit dhe nënpyetjeve përkatëse.

TABELA 1: MATRICA E THJESHTUAR E VLERËSIMIT

KRITERET E VLERËSIMIT	PYETJET E VLERËSIMIT
Përkatësia	Në çfarë mase përputhej teoria e ndryshimit e UNICEF-it me përparësitë dhe standardet e veta dhe përparësitë dhe vizionin e Shqipërisë?
	Në çfarë mase ka trajtuar teoria e ndryshimit e UNICEF-it nevojën për dhe pengesat ndaj përfshirjes sociale të fëmijëve dhe familjeve?
	Sa me vlerë është teoria e ndryshimit e UNICEF-it në kuadrin e veprimeve aktuale lidhur me nevojat dhe përparësitë që po hasen në Shqipëri?
Efikasiteti	Cilat ishin rezultatet e veprimeve të UNICEF-it lidhur me vendosjen e gurëve të themelit të sistemit të SHKSH-së?
	Sa sukses arriti UNICEF-i në përfshirjen e parimeve të UNICEF-it në punën e përditshme?
Efektshmëria	Në çfarë mase i optimizoi UNICEF-i asetet dhe avantazhet e veta krahasuar me të tjerë?
	Në çfarë mase i ka përdorur UNICEF-i sinergjitë me aktorë të tjerë, veçanërisht sa i përket vizionit të QSH-së dhe teorisë së ndryshimit, si dhe në kuadër të aktorëve të tjerë ndërkombëtarë dhe nismave të shoqërisë civile?
Ndikimi	Në çfarë mase ndikohen ndryshimet e gjera nga kontributi i UNICEF-it?
	A mund të gjurmohet kontributi i kuadrit të politikave normative i mbështetur nga UNICEF-i për ndryshimet në aksesin në SHKSH nga djemtë, vajzat, gratë dhe burrat si individë me të drejta?
Qëndrueshmëria	Sa gjasa ka që kontributi i UNICEF-it për kuadrin normativ të SHKSH-së në Shqipëri të ketë qëndrueshmëri në të ardhmen?

QASJA METODOLOGJIKE

Vlerësimi analizozi të dhëna sasiore dhe cilësore që mund të mblidhen në tre kategori: të dhëna të përgjithshme me rëndësi për të gjithë objektin e vlerësimit, të dhëna specifike të analizuar për tre rastet studimore tematike, si dhe të dhënat e analizuar për tre rastet studimore nga bashkitë. Për secilën kategori u përdorën instrumente të veçanta për mbledhjen e të dhënave. Më poshtë jepet një përmbledhje e grupeve të të dhënave dhe instrumenteve të mbledhjes së tyre.

TABELA 2: GRUPET E TË DHËNAVE DHE INSTRUMENTET E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

GRUPET E TË DHËNAVE	INSTRUMENTET E PËRDORURA PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE
Të dhëna të përgjithshme (me rëndësi për të gjithë objektin e vlerësimit)	Anketim përmes internetit; Intervista gjysmë të strukturuar me të intervistuar që kanë një panoramë të përgjithshme të veprimeve; Grupe fokusi dhe seminare me të intervistuar që kanë një panoramë të përgjithshme të veprimeve; Shqyrtim dokumentacioni.
Tre raste studimore tematike (Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, Aktet nënligjore për shportën e shërbimeve)	Shqyrtim i të gjithë dokumentacionit që gjurmon kontributin e UNICEF-it përgjatë procesit të përgatitjes dhe hartimit të rasteve të përzgjedhura; Shqyrtimi i varianteve të ndryshme të projekt dokumenteve të përzgjedhura Pyetje specifike gjatë intervistave me politikëbërës dhe ligjberës
Tre raste studimore nga bashkitë (Durrës, Malësi e Madhe, Përmet)	Intervista në bashkitë e përzgjedhura me personelin aktual dhe/ose të shkuar të NJVRF-ve, zyrtarë të tjerë përkatës dhe zyrtarë të zgjedhur në bashkitë e përzgjedhura, me përfituesit e SHKSH-së, OSHC-të vendore/kombëtare/ndërkombëtare; Mbledhje dhe shqyrtim i dokumenteve të tjera shtesë në bashkitë në fjalë (p.sh., kampione të udhëzimeve dhe udhëzuesve të vëna në zbatim në nivel vendor, kampione të vendimeve për shërbimet e kujdesit shoqëror, kampione të raporteve të hartuara në nivel vendor..)

Përmbledhtazi, në diskutimet në grupe fokusi u intervistuan dhe morën pjesë 110 individë, ndërsa 128 individët të tjerë shtesë morën pjesë në anketimin përmes internetit. Ata përfaqësojnë gëzuesit e të drejtave, shërbimet e kujdesit shoqëror dhe profesionistët e mbrojtjes sociale në nivel bashkie dhe rajoni, politikëbërësit dhe drejtuesit e qeverisë kombëtare, deputetët e kuvendit, sferën akademike, UNICEF-in në Shqipëri, zyrën rajonale të UNICEF-it, selinë qendrore të UNICEF-it, agjencitë e tjera të OKB-së, si dhe agjencitë donatore dhe OSHC-të. Mbledhja e të dhënave u krye në periudhën korrik - dhjetor 2019.

GJETJET

PËRKATËSIA

- ◆ **Gjetja 1:** Teoria e ndryshimit e kontributit të UNICEF-it në Shqipëri është zhvilluar në mënyrë progresive dhe organike, me drejtim organizativ strategjik minimal, përmes ecurisë së të nxënit nga ana e UNICEF-it në Shqipëri në një kontekst të veçantë.
- ◆ **Gjetja 2:** Pas faktit, qasja e ndërhyrjes rezultoi të ishte me rëndësi dhe koherente me standardet dhe qasjen strategjike botërore dhe rajonale të UNICEF-it.
- ◆ **Gjetja 3:** Vlera e shtuar kyçe e UNICEF-it në Shqipëri ishte të mishëronte dhënien përparësi fëmijëve dhe familjeve në kuadrin e reformës së shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me mandatin e UNICEF-it.
- ◆ **Gjetja 4:** Qëllimi i ndërhyrjes ishte me shumë rëndësi për nevojat dhe pengesat e hasura nga fëmijët dhe familjet, të identifikuar nga UNICEF-i në Shqipëri dhe nga përfituesit e intervistuar.
- ◆ **Gjetja 5:** Teoria e ndryshimit dhe vetë ndërhyrja e UNICEF-it në Shqipëri identifikuan gradualisht pengesat dhe pikat e bllokimit, dhe integruan analizën e tyre në sistem duke i dhënë kështu programeve rëndësinë e tyre.
- ◆ **Gjetja 6:** Kontributi, teoria e ndryshimit dhe vetë ndërhyrja e UNICEF-it në Shqipëri ishin në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë në kuadrin e të drejtave të njeriut, dhe u frymëzuan nga përparësitë kombëtare që lindin si pasojë e këtyre detyrimeve.
- ◆ **Gjetja 7:** Ndërhyrja është përshtatur me përparësitë që evoluojnë dhe dalin në pah duke punuar në kuadrin e reformave paralele dhe një mjedisi të ri politik, politikash dhe legjislativ, veçanërisht sa i përket decentralizimit.

EFIKASITETI

- ◆ **Gjetja 8:** Përmes lehtësimit të një procesi këshillues gjithëpërfshirës, UNICEF-i në Shqipëri ka dhënë kontribut që shërbimet e kujdesit shoqëror të qëndrojnë në rendin e ditës së politikëbërësve dhe vendim marrësve në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.
- ◆ **Gjetja 9:** Në nivelin e rezultateve të ndërmjetme, UNICEF-i në bashkëpunim me QSH-në, pati sukses në krijimin e konceptit të sistemit të shërbimeve shoqërore bazuar në gurët e themelit kryesorë të sistemit dhe në kuadrin përkatës normativ.
- ◆ **Gjetja 10:** Kontributi i UNICEF-it në Shqipëri ishte kritik në kuadrin e përcaktimit të qartë të paktën të tre gurëve të themelit: rezultatet e pritshme të hershme të ndërhyrjes janë arritur pjesërisht.
- ◆ **Gjetja 11:** Megjithatë, palët e interesit nuk janë në dijeni as të parimeve dhe as të gurëve të themelit, dhe kuadri normativ nuk është plotësuar ende: kushtet e krijuara nuk janë të mjaftueshme që gurët e themelit të vihen në funksion, dhe rezultatet e hershme vijojnë të jenë tranzitore.
- ◆ **Gjetja Nr. 12:** UNICEF-i në Shqipëri ka pasur sukses në futjen e shumicës së parimeve të veta, të paktën deri në një farë mase, në frymën e kuadrit normativ.
- ◆ **Gjetja 13:** Financimet dhe modalitetet financiare që mbështesin sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror mbeten ende një çështje pa zgjidhje, çka vë në rrezik serioz rezultatet e ndërhyrjes.

EFEKTSHMËRIA

- ◆ **Gjetja 14:** UNICEF-i në Shqipëri ka përdorur intensivisht burimet e veta të brendshme unike dhe asetet e vëna në dispozicion të tij, por agjencia mund të kishte optimizuar më tej potencialin e advokimit të saj për të ndihmuar në përshpejtimin e hartimit të kuadrit normativ në nivelin ligjvënës.
- ◆ **Gjetja 15:** Në mungesë të një teorie të fuqishme të ndryshimit dhe monitorimit sistematik përkatës, UNICEF-i në Shqipëri nuk kishte mjaftueshëm mjetet e duhura për të drejtuar ndërhyrjen e vet dhe përdorimin e veprimeve të veta në një mënyrë proaktive dhe të dokumentuar.
- ◆ **Gjetja 16:** UNICEF-i në Shqipëri mobilizoi përvojë të shkëlqyer, por nuk i dha ekspertëve udhëzime të qarta, ose nuk monitoroi përqendrimin e tyre tek parimet që ata duhet të promovonin.
- ◆ **Gjetja 17:** Falë qasjes gjithëpërfshirëse të bazuar në partneritet, kontributi i UNICEF-it, ishte më së paku plotësues dhe shpesh në sinergji me vizionin dhe strategjitë e Qeverisë, aktorëve të shoqërisë civile dhe palëve të tjera ndërkombëtare të interesit.
- ◆ **Gjetja 18:** Në kontekstin e menaxhimit të partneriteteve, qasja e kujdesshme për advokimin e përdorur nga UNICEF-i, nuk ndihmoi në tejkalimin e çështjes së rëndësishme penguese të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

NDIKIMI

- ◆ **Gjetja 19:** Kontributi i UNICEF-it në Shqipëri për kuadrin normativ për shërbimet e kujdesit shoqëror ka ushqyer një kërkesë në rritje për shërbime të kujdesit shoqëror.
- ◆ **Gjetja 20:** Zbatimi tranzitor i kuadrit normativ për shërbimet e kujdesit shoqëror krijon riskun e efekteve negative për mbrojtjen e fëmijëve, për sa kohë që supozimi i financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror me fonde publike nuk realizohet dhe për sa kohë që mbrojtja e fëmijëve dhe shërbimet e kujdesit shoqëror nuk integrohen në mënyrë të fuqishme.
- ◆ **Gjetja 21:** Kuadri normativ të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ashtu siç është promovuar nga UNICEF-i në Shqipëri, mund të përfitonte nga ndërlidhje më të fuqishme me fusha të tjera të veprimtarisë së vazhdueshme të Qeverisë që ndikojnë pozitivisht në mbrojtjen sociale dhe në të drejta të tjera ekonomike dhe shoqërore.
- ◆ **Gjetja 22:** Në këtë fazë ka vetëm prova sporadike lidhur me ndikimin e matshëm të kuadrit normativ tek gëzuesit e të drejtave.

QËNDRUESHMËRIA

- ◆ **Gjetja 23:** Fuqia punëtore e shërbimeve të kujdesit shoqëror po vepron si një tampon me gëzuesit e të drejtave, në një sistem që perceptohet si jo efikas gjatë periudhës aktuale tranzitore të reformës. Kjo mund të rrezikojë qëndrueshmërinë e këtij guri themeli të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- ◆ **Gjetja Nr. 24:** Në kontekstin e interesit të ripërtërirë ndërkombëtar për mbrojtjen sociale, UNICEF-i në Shqipëri ka mundësi të ketë një rol të ripërtërirë dhe të fuqishëm gjatë negociatave të fundit për kuadrin normativ për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe për zbatimin e tyre në jetën e gëzuesve të të drejtave.

PËRFUNDIME

Teoria e ndryshimit e UNICEF-it në Shqipëri për vlerësimin e ndërhyrjes, së brendshmi ishte në koherencë dhe me rëndësi për nevojat e identifikuara në momentin përkatës. Gradualisht, UNICEF-i në Shqipëri përcaktoi dhe integroi parimet kyçe që duheshin përfshirë në sistemin e SHKSH-së në Shqipëri. Kjo maksimalisht koherente dhe me rëndësi në kuadrin e mandatit, parimeve, përparësive dhe njohurive. Sistemi i propozuar dhe parimet e barazisë, përqendrimit në ciklin e jetës, aksesueshmërisë, qëndrueshmërisë, llogaridhënies dhe efektshmërisë janë gjithashtu me rëndësi sa i përket detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, që rrjedhin nga përparësitë strategjike dhe synimet evropiane.

Në nivelin e aktiviteteve të ofruara, UNICEF-i në Shqipëri ka mundur me efikasitet këshillimin, advokimin, ekspertizën, punën kërkimore dhe financimin e tij që sistemi i SHKSH-së të qëndrojë në rendin e ditës. Me nisjen e kësaj ndërhyrjeje, UNICEF-i në Shqipëri arriti të informonte vendim marrjen e vet dhe atë të Qeverisë së Shqipërisë për nevojat shoqërore dhe të drejtave të papërbushura të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve, përmes të dhënave, punës kërkimore dhe analizave. UNICEF-i në Shqipëri, përmes mbështetjes së përkushtuar të Agjencisë Zviceriane për Zhvillim, frymëzoi më tej përgatitjen e kuadrit normativ me ekspertizë të avantazhuar të mobilizuar përbrenda organizatës dhe ndërmjet promotorëve të ndryshimit. Kështu, UNICEF-i ka dhënë kontribut për vendosjen dhe mbajtjen e vizionit të vet ndër përparësitë e Qeverisë dhe partnerëve, përmes lehtësimit të një dialogu përfshirës midis profesionistësh të informuar. Ky debat ka përmirësuar gjithashtu edhe barazinë gjinore në nivel strategjik. UNICEF-i ka ndërmarrë një ndërhyrje ambicioze, me vlerë të mirë për sasinë e fondeve të përdorura, zhdërvjelltësi dhe angazhim të thellë, me një financim relativisht modest. Megjithatë, kjo qasje nuk u përmblohd kurrë në një teori ndryshimi dhe nuk u monitorua si e tillë deri në momentin e këtij vlerësimi.

Në nivelin e rezultateve të ndërmjetme, UNICEF-i në Shqipëri ka dhënë kontribut për përgatitjen e kuadrit normativ të sistemit të SHKSH-së si koncept. UNICEF-i ka arritur sinergji të ngushtë me Qeverinë dhe partnerët e tjerë. Ky partneritet ka sjellë rezultate premtuese: Shqipëria ka miratuar arkitekturën e saj të sistemit të SHKSH-së, që përputhet mirë me qasjen e UNICEF-it për sistemet dhe që përfshin parimet e tij, megjithëse në mënyrë të fragmentuar. Së bashku me partnerët e vet shqiptarë, UNICEF-i në Shqipëri, e ngriti diplomën e punonjësit social në nivelin e standardeve ndërkombëtare, duke dhënë kështu kontribut për krijimin e një force punëtore të kualifikuar për SHKSH-në. Kontributet e mbarënjohura të UNICEF-it kanë krijuar kushte kyçe për një sistem SHKSH që përputhet me legjisllacionin, që është efikas dhe i efektshëm. Në përgjithësi, pesë gurët e themelit të sistemit synojnë fëmijët dhe familjet e tyre, dhe kjo më së shumti falë UNICEF-it në Shqipëri.

Megjithatë, shumë bashki nuk janë angazhuar ende në një analizë nevojash, planifikim dhe ngritje kapacitetesh kuptimplota, përfshirëse dhe me ndjeshmëri gjinore për SHKSH-në, dhe ato kanë ende nevojë për mbështetje në hartimin e planit të tyre shoqëror. Rregulloret që lidhen me të gjithë gurët e themelit duhet të mirëpërcaktohen më tej dhe të vihen në funksion sa i përket atyre që kanë detyrat përkatëse.

Përveç kësaj, nga pikëpamja e rezultateve të menjëhershme, dy gurë themeli nga pesë gjithsej janë ende në ngritje e sipër: financimi dhe vënia në funksion e shportës së shërbimeve të kujdesit shoqëror. Përgjatë kohëzgjatjes së ndërhyrjes, UNICEF-i punoi me tre gurë të rëndësishëm themeli (instrumentet dhe metodat, si dhe trajnimin e forcës punëtore të SHKSH-së, por dhe me disa procese vendim marrëse), por shtyu përpjekjet e veta të advokimit lidhur me dy gurët e tjerë.

Si rrjedhojë, sa i përket ndikimeve, ky kuadër nuk është zbatuar ende dhe parimet e UNICEF-it nuk janë kanalizuar ende në jetën e gëzuesve të të drejtave: supozimi i brendshëm që grupet e synuara do të kishin akses në të drejtat ekonomike dhe shoqërore nuk është realizuar ende. Një sërë supozimesh të jashtme kyçe, përfshirë financimin e sistemit dhe integrimin e mbrojtjes së fëmijës dhe SHKSH-së nuk janë përmbushur sa i përket nivelit të ndikimit, dhe ka shqetësime serioze lidhur me qëndrueshmërinë e sistemit të SHKSH-së.

Me përjashtim të bashkisë Tiranë, SHKSH-ja është ende në hapat e parë dhe gëzuesit e të drejtave nuk kanë akses në shërbime të mjaftueshme cilësore. Në mungesë të financimit përpjesëtimor nga niveli vendor apo ai qendror, përgjegjësitë shtesë që u janë caktuar bashkive faktikisht po rëndojnë tek profesionistët e mbrojtjes së fëmijës në bashki: ka shqetësime të vazhdueshme që kjo situatë, megjithëse tranzitore, mund të pengojë mbrojtjen e fëmijëve. UNICEF-i në Shqipëri mund të kishte punuar në mënyrë më proaktive lidhur me planifikimin e përbashkët për të dy shërbimet. Gëzuesit e të drejtave duhet ende të vihen në dijeni mbi të drejtat e tyre lidhur me SHKSH-në. Tek hasin vonesa në zbatim dhe duke qenë se veprojnë si një tampon në këtë periudhë tranzitore të reformës, punonjësit e SHKSH-së përballen me zhgënjime.

Plotësimi i përmbajtjes së saktë, harmonizimit dhe zbatimit të kuadrit normativ do të kërkojë një advokim të rifreskuar nga ana e UNICEF-it në Shqipëri. Mekanizmat e cilësisë dhe llogaridhënies, si inspektimi dhe monitorimi, kërkojnë ende miratimin e akteve rregullatore dhe ekspertizën e UNICEF-it në Shqipëri.

Çka është më e rëndësishme, financimi për SHKSH-në është ende në fazë negocimi dhe këto negociata kanë mbetur në vend, ndërkohë që trysnia shtohet. Rëndësia financiare dhe politike e SHKSH-së rritet ndërkohë që sistemi vihet në funksion, dhe aq më tepër në kuadër të ndërhyrjes së UNICEF-it në Shqipëri. Po ashtu, kërkesa për SHKSH po nis të rritet ngadalë në nivel vendor, një supozim i brendshëm ky që është realizuar pjesërisht.

Tani nuk është momenti që UNICEF-i në Shqipëri të tërhiqet nga kjo reformë: ai duhet të ripërcaktojë rolin e vet lidhur me shërbimet e kujdesit shoqëror dhe mënyrën se si e formulon qëndrimin e vet në kuadër të mandatit për mbrojtjen e fëmijëve. UNICEF-i në Shqipëri duhet të kombinojë rolin e advokuesit, që nënkupton vendosjen e kufijve të qartë dhe shprehjen e mesazheve të qarta, me atë të një ndërmjetësi të ndershëm që kërkon një farë paanësie ndërmjet palëve të interesit. Shumë palë interesi e presin këtë gjë. Partneriteti i ngushtë me BE-në si një donator i ri kyç në fushën e mbrojtjes sociale, ka gjasa të ndihmojë UNICEF-in në Shqipëri të rifreskojë rolin e vet. Ky ripërcaktim mund të kërkojë që UNICEF-i në Shqipëri të përshtasë marrëdhëniet e veta me partnerë të ndryshëm: ndërkohë që niveli i besimit dhe afërsisë së arritur kanë qenë kritik deri më tani, tashmë mund të jetë i nevojshëm një qëndrim më i qartë por gjithashtu edhe më i distancuar. Me qëllim informimin e këtyre vendimeve, programi nuk ka monitoruar ende perceptimin e gëzuesve të të drejtave për SHKSH-në, kështu që nuk ka një bazë fillestare për të monitoruar ofrimin e SHKSH-së dhe përvojat e gëzuesve të të drejtave.

Me qëllim vijimin e këtij roli në një vend të vogël, UNICEF-i në Shqipëri dhe zyrat e tjera që dëshirojnë të përsërisin këtë përvojë do të kenë nevojë për mbështetje dhe udhëzim nga organizata e tyre. UNICEF-i duhet të hartojë strategjitë dhe metodologjitë e veta për SHKSH-në, bazuar në suksesin dhe mësimet e nxjerra nga zyra e vet në Shqipëri dhe nga zyra të tjera, kryesisht në VAM. Stafi i UNICEF-it dhe këshilltarët e tij do të përfitonin nga udhëzime të tilla, që do të përforconin qëndrimin dhe mesazhin e tyre në negociata të rëndësishme të lartë. Paralelisht, UNICEF-i duhet të marrë në konsideratë monitorimin e ofrimit të SHKSH-së dhe ngritjen e kapaciteteve kombëtare për të vijuar monitorimin, si në kuadër të mekanizmave të brendshëm të llogaridhënies të sistemit të SHKSH-së, ashtu edhe në kuadër të shoqërisë civile dhe institucioneve të të drejtave të njeriut. Caktimi i etapave dhe mbështetja nga kolegët janë kritike për këtë fazë të re, dhe UNICEF-i duhet të marrë vërtetë në konsideratë veprimin në nivel vendor, duke krijuar një komunitet praktike ndërmjet punonjësve socialë shqiptarë dhe kolegët e tyre në rajon dhe më tej.

MËSIMET E NXJERRA

- a. Kur UNICEF-i fillon të punojë në një fushë të re pune, ai zbaton procesin me hapa të eksperimentimit dhe të nxënit për të arritur rezultate që hapin rrugën më tej. Ndërhyrja e vlerësuar që mbështet ngritjen e një sistemi të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri ka qenë një përvojë e tillë e "të nxënit nga përvoja". Përgjatë të gjithë përvojës, UNICEF-i në Shqipëri rregulloi qasjen e vet për promovimin e parimeve të veta kyçe në një mjedis sfidues, ndërkohë që kryente punë për të vendosur piketat për veprimtaritë e ardhshme.

Megjithëse kjo është një fazë e natyrshme për një organizatë që mëson, dhe një organizatë që është e përkushtuar drejt novacionit ashtu si UNICEF-i, sëbashku me trysnitë që këto krijojnë, duket të kenë kufizuar aftësinë e UNICEF-it në Shqipëri për të formuluar një teori ndryshimi dhe për ta monitoruar atë sistematikisht. Kur agjencia nisi punën për SHKSH-në, nuk kishte udhëzime në mbarë UNICEF-in për këtë çështje. Në këto raste, zyrat lokale kanë nevojë për udhëzime të fuqishme dhe mbështetje teknike nga organizata: ato kanë nevojë për një kanal të fuqishëm komunikimi, të nxëni dhe drejtimi.

Me qëllim plotësimin e këtyre nevojave, është e dobishme të ketë një logjikë ndërhyrjeje të përcaktuar shprehimisht në një teori ndryshimi. Kjo lejon monitorimin sistematik të supozimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe të zinxhirit të shkaqeve dhe pasojave. Gjithashtu, zbatimi i një procesi për monitorimin e teorisë së ndryshimit, lehtëson të nxënit në bashkëpunim nga ana e ekipit lokal, Zyrës Rajonale dhe me shumë mundësi edhe selisë qendrore të UNICEF-it. Në këtë mënyrë, UNICEF-i mund të mbështesë përpjekjet për të ecur përpara përmes rrjeteve horizontale që mund të mobilizohen në kohe, dhe që veprojnë si një task forcë për ekspertizën, mbështetjen dhe reagimin.

- b. Plotësimi i projektit fillestar të kuadrit normativ me nismat pilot në nivel vendor, është mënyrë e mirë për të mësuar nga përvojat në terren dhe për të sjellë njohuri në sistem. Megjithatë, vetëm zbatimi i projekteve pilot nuk mjafton. Në periudhën afatgjatë, është e nevojshme të monitorohet mënyra e shpërndarjes të sistemit në terren. Kjo arrihet më mirë kur bëhet në partneritet me një sërë aktorësh kombëtarë monitorimi që plotësojnë njëri-tjetrin: mekanizma mbikëqyrës të brendshëm, institucione të pavarura shtetërore dhe shoqëria civile. Ngritja e kapaciteteve për të monitoruar efektet e sistemeve të sapo reformuara apo të ngritura dhe vëna në funksion, është një alternativë e mirë, por suksesi i saj kërkon një kuadër të shëndoshë monitorimi të brendshëm.
- c. Një qasje bazuar në sisteme është punë afatgjatë: është e natyrshme që roli i UNICEF-it do të evoluojë përgjatë gjithë kohëzgjatjes. Megjithatë, një evoluim i tillë menaxhohet më mirë kur është një zgjedhje e ndërjegjshme. Kombinimi i roleve si ekspert këshillues i besuar i qeverisë, lehtësues rrjeti, advokues dhe ndërmjetës i ndershëm, mund të jetë i përshtatshëm për të gjetur shtigje në situata të ndërlikuara politike, por ky kombinim është tejet i vështirë. Roli themelor i ndërmarrë duhet të jetë i qartë dhe 'caqet e pakalueshme' ose parimet themelore duhet të jenë të shprehura qartë. Puna në partneritet me qeverinë është koherente dhe e dobishme, por duhet të ketë një kufi të caktuar mirë bazuar në parime kyçe dhe advokim të vazhdueshëm përgjatë ndërhyrjes, në mënyrë që supozimet

kyçe të mos mbeten të parealizuara, ose kur nuk realizohen dhe problemi është identifikuar, të ketë një plan të qartë veprimi.

- d. Me kalimin e kohës, në ndërhyrje të orientuara nga sistemi si ky, mungesa e një teorie ndryshimi dhe kuadri përkatës monitorimi (përfshirë monitorimin e riskut dhe supozimeve të jashtme) nuk ndihmon në marrjen e vendimeve të informuara. Faktikisht, kjo mungesë dobëson aftësinë për të dokumentuar zgjedhjet për qëllime të nxëni apo për të kanalizuar siç duhet ekspertizën e jashtme përmes udhëzimeve të qarta, të orientuara nga rezultatet dhe të kufizuara tek standardet.
- e. Në një ndërhyrje të orientuar nga reforma dhe që ndjek qasjen e sistemeve, shtyrja e negociatave dhe e vendimeve kritike që krijojnë polemika, si ato që lidhen me përgjegjësitë financiare apo integritimin e shërbimeve plotësuese (në këtë rast shërbimet e kujdesit shëndetësor, ndihma në para në dorë dhe mbrojtja e fëmijës) përbën risk. Është gjithashtu me rrezik që këto vendime të lihen për një shkallë më të ulët aktesh ligjore (si udhëzimet ministrore, në vend të ligjeve apo rregulloreve ndër-ministrore). Megjithëse për momentin mund të krijojnë tensione, veprime të tilla nënkuptojnë që vendimet më të vështira do të duhet të merren atëherë kur trysnia është më e madhe: në momentin e vënies në funksion dhe zbatimit. Ka risk të mbetjes në vend numëro dhe të zhgënjimit nga ana e përfituesve të reformës. Zbatimi i një taktike shtyrjeje duhet të jetë gjithmonë një zgjedhje e ndërgjegjshme dhe e bazuar në informacion, dhe duhet të jetë e qartë që një zgjedhje e tillë do të kërkojë advokim të ripërtërirë dhe të fuqishëm në të ardhmen gjatë fazës kur ndërhyrja është e pjekur. Advokimi i fuqishëm në fillim, por që vjen duke u pakësuar me kalimin e kohës nuk përputhet me një qasje të tillë.
- f. Koherenca e brendshme ndërmjet ndërhyrjeve të UNICEF-it në Shqipëri ndikon ndërlidhjen e jashtme të sektorëve të mbështetur. Kështu që, është kritike të ndërmerret bashkëplanifikim i ndërhyrjeve të mbështetjes në sektorë që plotësojnë njëri-tjetrin. Zakonisht, ndërveprimi midis programeve të mbrojtjes së fëmijës dhe sistemeve të tjera të mbështetura nga UNICEF-i duhet të parashikohet sa më saktë të jetë e mundur që në fazat e projektimit. Dokumentet e planifikimit, qofshin dokumentet e vetë UNICEF-it apo ato që ka promovuar në nivel vendor, duhet të integrohen sa më shumë të jetë e mundur. Mesazhet e advokimit duhet të jenë konsekuente dhe të jepen në momente kur kërkohet advokim i përgjithshëm. Kjo lehtëson zbatimin dhe monitorimin dhe mund të shmangë efektet negative të një plani tek një tjetër. Koordinimi dhe shkëmbimi i informacionit nuk mjaftojnë. Sinergji të tilla të brendshme kërkojnë drejtim të fuqishëm për të lehtësuar të menduarin e përbashkët strategjik, që shkon edhe përtej dokumenteve strategjike të vendit dhe vizionit të tyre pesë vjeçar, sepse mbështetja e sistemeve dhe sektorëve të tërë është përpjekje afatgjatë.
- g. Ndërhyrjet e orientuara nga sistemet duhet të identifikojnë, monitorojnë nga afër dhe, për sa është e mundur, t'i paraprijnë reformave kritike paralele. Kjo ndërhyrje ka përdorur në mënyrën më të mirë të mundshme reformat themelore paralele, si reformën e vetë-qeverisjes vendore, që e përdori si mundësi dhe jo si kërcënim për të qartësuar dhe mundësuar rolin e çdo niveli qeverisjeje për ofrimin e shërbimeve. Mund të kishte qenë tunduese të pritej që një reformë kaq themelore si ajo e vetë-qeverisjes vendore të përfundonte, dhe më pas të përshtatej arkitektura e sistemit të promovuar nga UNICEF-i, ose që shërbimet shoqërore të zhvilloheshin të izoluar nga reforma e vetë-qeverisjes vendore. Por duke bërë zgjedhjen e guximshme për të përqaftuar këtë reformë dhe për të punuar mbi të, UNICEF-i ndihmoi reformën duke shmangur krizat e mundshme, por edhe ruajti praninë e vet në qarqet më të rëndësishme të vendim marrjes.
- h. Lehtësimi i përfshirjes për një gamë të gjerë aktorësh në debat dhe në përgatitjen e kuadrit normativ përfaqëson një investim të konsiderueshëm për momentin, por që ishte plotësisht i justifikuar. Ndërhyrjet e orientuara nga sistemet përfitojnë shumë nga lehtësimi

i dialogut përfshirës për politikat dhe platformat përkatëse. Zakonisht, këto qasje rrisin dobinë e ndërhyrjes, legjitimitetin e UNICEF-it, cilësinë e reformës dhe qëndrueshmërinë e saj. Gjithashtu, ato ndihmojnë në identifikimin dhe fuqizimin e agjentëve për ndryshim, të cilët japin kontributin e tyre që synimi i ndërhyrjes të qëndrojë në rendin e ditës, që në vetvete është nevojë për ndërhyrjet të orientuara nga sistemet të cilat trajtojnë sektorë apo tema ku nevojiten investime afatgjata. Zgjerimi i këshillimeve kund të sjellë edhe rezultate transformuese nga pikëpamja e gjinisë, si ekuilibrimin e pjesëmarrjes së grave dhe burrave në procesin e vendim marrjes.

- i. Ndërkohë që veprimet janë përqendruar kryesisht tek familjet dhe fëmijët, dhe në këtë kuadër duke synuar kryesisht gratë, djemtë dhe vajzat, ekipi i vlerësimit nuk arriti të identifikojë një analizë me bazë gjinore të pengesave dhe të nevojave të grupeve të synuara në dokumentacion. Bazuar në intervista dhe nga sa kuptohet nga dokumentacioni, duket se veprimet u konsideruan të kishin pikëpamje gjinore të nënkuptuar, dhe se sillnin 'natyrisht' rezultate transformuese gjinore duke fuqizuar gratë, burrat, vajzat dhe djemtë të integroheshin nga pikëpamja shoqërore, megjithëse natyra e këtyre rezultateve transformuese gjinore nuk është formuluar asnjëherë shprehimisht. Analiza gjinore e problemit të trajtuar një ndërhyrje e orientuar nga sistemi, analiza e shkaqeve bazë dhe e efektit të korrigjimeve të mundshme, duhet të qëndrojë në thelb të kërkimeve fillestare duke siguruar informacion për këtë ndërhyrje. Bazuar në këtë analizë fillestare, këto ndërhyrje duhet të parashikojnë rezultatet transformuese gjinore dhe të shmangin pabarazitë gjinore të njëpasnjëshme. Së fundmi, ato duhet të monitorojnë dhe dokumentojnë veprimet që ndërmarrin për të korrigjuar këto pabarazi. Për shembull, burrat kishin më shumë gjasa të përfshiheshin drejtpërsëdrejti në hartimin e planeve shoqërore se sa gratë, sepse ata kanë më shumë pushtet vendim marrës në nivel bashkie. Kjo mund ta kishte drejtuar UNICEF-in në Shqipëri të risillte shprehimisht në ekuilibër barazinë gjinore në proceset e planifikimit dhe vendim marrjes gjatë proceseve lehtësuese dhe më pas të monitoronte këto rezultate transformuese gjinore në mënyrë specifike.
- j. UNICEF-i në Shqipëri ka drejtuar paralelisht zhvillimin e arkitekturës së shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe zhvillimin e një grupi profesionistësh të kujdesit shoqëror që janë të gatshëm për vënien në funksion dhe zbatimin e sistemit. Ngritja e kapaciteteve njerëzore të partnerëve kombëtarë përmes hartimit të kurrikulave dhe diplomave, ndërkohë që paralelisht mbështetet një sistem, është diçka efikase dhe e qëndrueshme.
- k. Në vendet e vogla, ekspertiza e disponueshme për tema të specializuara siç është SHKSH-ja, mund të kthehet në një rreth të ngushtë me 'persona të njohur', çka mund të dëmtojë novacionin dhe marrjen e vendimeve të guximshme politike. Korrigjime të përshtatshme të kësaj shtate, janë edhe përfshirja e kolegëve nga vende fqinje dhe të tjera, dhe zgjerimi gradual i rrethit të palëve të interesit në vend. Ekspertët kanë nevojë për udhëzime të qarta dhe të fuqishme dhe për monitorim lidhur me teorinë e ndryshimit për të cilën japin kontribut, lidhur me parimet që ata bëjnë pjesë të jetës së përditshme dhe lidhur me rolin e tyre në ndërhyrje. Duhet të ketë një perceptim të qartë se ndërkohë që ekspertiza, puna kërkimore dhe pilotimi i disa instrumenteve mund të ofrohet si nga UNICEF-i po ashtu edhe nga konsulentë të jashtëm, roli advokues dhe këshillues për vendim marrësit i përket UNICEF-it si organizatë, dhe për rrjedhojë stafit të tij.
- l. Partneriteti me një donator të përkushtuar për të krijuar dhe rimodifikuar një ndërhyrje që i qaset sistemeve është një nga elementët që garanton cilësinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e ndërhyrjes. Falë këtij partneriteti, UNICEF-i Shqipëri ishte i aftë të ofronte vlerë të lartë për koston e ndërhyrjes dhe një menaxhim të zhdërvjellët të ndërhyrjes.

REKOMANDIMET KRYESORE

1. **UNICEF-i në Shqipëri duhet të zgjerojë mbështetjen e vet për sistemin e SHKSH-së në periudhën afatshkurtër me qëllim përshtatjen sa më të mirë dhe vënien në zbatim të kuadrit normativ. Për të bërë diçka të tillë, ai duhet:**
 - 1.1. Të riangazhojë palët e interesit dhe vendim marrësit, duke vepruar si një ndërmjetës i ndershëm për përcaktimin e financimit.
 - 1.2. Të mbështesë sistematikisht MSHMS për përfundimin e hartimit të procedurave, standardeve dhe udhëzimeve për profesionistët, me qëllim lehtësimin e zbatimit të kuadrit normativ dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror (kritike).
 - 1.3. Të mbështesë sistematikisht bashkitë për zbatimin e kuadrit normativ për SHKSH-në, kryesisht përmes planeve shoqërore të mirëplotësuara bashkiake (kritike dhe urgjente).
 - 1.4. Të mbështesë Qeverinë e Shqipërisë dhe palët përkatëse të interesit në rishikimin, qartësimin dhe përshtatjen sa më të mirë të kuadrit normativ (kritike).
 - 1.5. Të krijojë mekanizma gjithëpërfshirës monitorimi për ofrimin e shportës së plotë të shërbimeve në disa bashki të përzgjedhura (kritike).

2. **UNICEF-i në Shqipëri duhet të mbështesë personelin e kujdesit shoqëror për t'u bërë një organ profesionistësh të organizuar, të zhvilluar nga pikëpamja profesionale, të aftë dhe të njohur zyrtarisht. Për të bërë diçka të tillë, ai duhet:**
 - 2.1. Të promovojë tek qeveria një rritje të numrit të punonjësve socialë të punësuar në NJVNR (kritike).
 - 2.2. Të krijojë një praktikë komunitare ndër profesionistët e SHKSH-së dhe Punës Sociale (e rëndësishme).
 - 2.3. Të promovojë diplomat e punës sociale tek burrat dhe të promovojë pjesëmarrjen e tyre dhe kontributin e tyre për SHKSH-në (pozitive nëse arrihet).

3. **UNICEF-i në Shqipëri, së bashku me Zyrën Rajonale, duhet të japë kontribut për një grup burimesh strategjike të përkushtuara specifikisht për SHKSH, si dhe për planifikimin e ndërhyrjeve të orientuara për forcimin e sistemeve, duke dhënë kështu kontribut për një organizatë që mëson. Për të bërë diçka të tillë, ai duhet:**
 - 3.1. Të mbështetet nga Zyra Rajonale dhe të hartojë një udhëzues për analizën gjinore si pjesë e kërkimeve fillestare dhe analizës së pengesave ndaj përfshirjes sociale dhe nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror (e rëndësishme).
 - 3.2. UNICEF-i në Shqipëri duhet të zbatojë planifikim dhe monitorim bazuar në teorinë e ndryshimit dhe të trajtojë stafin e vet në këtë kuadër (e rëndësishme).
 - 3.3. Mbështetur nga Zyra Rajonale, të hartojë një përkufizim të koncepteve dhe parimeve kyçe, si dhe të hartojë udhëzues strategjik për ndërhyrjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror (e rëndësishme).

unicef 

for every child